



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 1769 /2022
Data: 09.03.2022

PROCESVERBALI
I KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

Nga mbledhja e dytë -II- për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur me datë 15.02.2022 me fillim pune në ora 11:00 në sallën e takimeve. Të pranishëm ishin: **Sevdi Dernjani** (Nënkryetari i Komunës), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoresh për Zhvillim Ekonomik), **Kimete Kuka -Hasallari** (Drejtoreshë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale), **Nexhmedin Daci** (Drejtorja për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Arsim Dernjani** (Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjencë), **Lindita Ballazhi** (Drejtoresh për Buxhet dhe Financa), **Bajrush Laçi** (Shef i Zyrës Ligjore), **Sevime Bajrami** (Kryesuese Komisionit të Aksionarëve të NLP Pastrimi sh.a), Bashkim Sopa (Zyrtarë për Informim). Kryesuesi pasi konstatoi prezencën e anëtarëve të KPF-së, konstatoi se nuk mungon asnjë anëtarë i Komitetit për Politikë dhe Financa.

RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021.
3. Raporti financiar për vitin 2021.
4. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.
5. Propozim vendim për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në komunën e Hanit të Elezit.
6. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.
7. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.
8. Plani i punës së komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2022.
9. Raporti financiar për vitin 2021 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.
10. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.
11. Të ndryshme.

Kryesuesi thekson:- për pikat e rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA RENDI I PUNËS

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U MIRATUA PROCESVERBALI NGA MBLEDHJA E KALUAR

2. Raporti i punës së kryetarit të komunës për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevdi Dernjani thekson:- te raporti i kryetarit të komunës për vitin 2021 nuk është paraqitur raporti i gjashtë mujorit të dytë për arsye se nuk kemi pranuar asgjë nga ish kryetari i komunës. Kryetari i Komunës e ka pranuar detyrën me datë 26.11.2022 për muajin dhjetorë i ka raportuar dy donacione nga kontingjenti Italian , njëri ka të bëjë për panelet solar në objektin e komunës , ndërsa tjetri është për donacionin që është bërë për te çerdhja.

Sherif Berisha thekson:- a ka ndonjë arsye pse nuk është lënë raport.

Sevdi Dernjani thekson:- nuk ka dorëzuar raport për aktivitet , ndërsa zyra e personelit, zyra e informimit, zyra e prokurimit janë zyre aktuale të cilat janë në kabinetin e kryetarit të komunës dhe kemi mundur me marr raporte, ndërsa raporti i kryetarit është direkt me kryetarin dhe nuk është me mandat dhe nuk kemi mundur me marr raport prej tij

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

3. Raporti financiar për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- lidhur me këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Lindita Ballazhi thekson:- buxheti për vitin 2021 ka qenë në lartësi prej 2,520,165.91 € dhe prej tyre Paga dhe shtesa 1,602,780.91 €, Mallra dhe shërbime 335,258.00 €, Shpenzimet komunale 67,000.00 €, Subvencione dhe transfero 75,000.00 €, Shpenzime kapitale 385,127.00 €, Rezervat 55,000.00 €. Ndërsa buxheti përfundimtarë buxheti përfundimtar është në shumë prej 2,686,554.11 €, që d.m.th. është rritur buxheti edhe për 166.388.20€ duke përfshirë: Bartjen e mjeteve të pashpenzuara nga të hyrat vetanake të vitit 2020 në shumë prej 57,779.88 €; Donacionet e pashpenzuara IPA FONDE të vitit 2020 në shumë prej 24,696.82 €; Donacioni nga DEMOS – për ngritjen e performancës komunale, në shumë prej 41,687.00 €; këto mjete janë shfrytëzuar sipas marrëveshjes për projektin “Shtimi i kapaciteteve të ujit dhe rregullimi i rrjetit të ujësjellësit”; Bazuar në vendimet nga Qeveria e Republikës së Kosovës janë ndarë mjete shtesë për luftimin e Covid-19 në vlerë 42,174.50 €; për shtesat mujore mbi pagën bazë. Nisur nga vlerësimi i përgjithshëm del se niveli i shpenzimit të buxhetit për vitin 2021 është në shumë prej 2,634,463.47 € apo 98.06 %. Paga dhe shtesa janë shpenzuar 1,645,045.11€ apo 99.55 %, Mallra dhe shërbime 348,741.08€ apo 98.75 %, Shpenzime komunale 64,899.87 € apo 96.87 %, Subvencione dhe transfere 72,465.00 € apo 90.25% dhe Shpenzime kapitale 503,312.41 € apo 88.05 %. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Refet Kalisi thekson:- a kemi obligime ndaj kompanive për projektet kapitale për vitin e kaluar. A ka ndonjë projekt që është paguar e nuk është kryer.

Sherif Berisha thekson:- a keni informacionet për orët shtesë për zyrtarët të cilët janë paguar.

Lindita Ballazhi thekson:- kemi obligime. Sa i përket projekteve nuk kam informacion. Pasi që në muajin dhjetor kam filluar me punë dhe këtë raport financiar jam te prezantuar dhe nuk jam shumë në rrjedha, mirëpo në fund të vitit ka pasur retroaktiv për zyrtarët dhe janë realizuar shujtat e arsimtarëve dhe një pjesë e shujtave për stafin komunal për vitin 2020.

Sherif Berisha thekson:- kërkojnë një arsytim për zyrtarët të cilët janë paguar për orët shtesë se a kanë ndonjë arsytim, në mënyrë që të dihet se kush ka qenë më i privilegjuar.

Sevdi Dernjani thekson:- nëse ju intereson diçka më specifike mund të na dërgoni ndonjë Email për kërkesë në qasje në dokumentet publike dhe mund të ju sigurohen.

Sherif Berisha thekson:- e dimë se si shkon forma për me bërë kërkesë për qasje në dokumentet zyrtare dhe do ta bëjmë por këtu mund të bisedojmë dhe mund të na sigurohen këta që po i kërkojmë.

Refet Kalisi thekson:- secila drejtori i ka kompensuar punëtorët e vetë të cilët kanë punuar pas orarit të punës.

Kryesuesi thekson:- këshilltarë kanë të drejtë me kërkuar informacione dhe ekzekutivi duhet të ju përgjigjet sipas procedurave ligjore. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI FINANCIARË PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

4. Raporti i punës së kuvendit të komunës për vitin 2021.

Kryesuesi thekson:- materialin e keni pranuar me kohë dhe nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS PËR VITIN 2021 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

5. Propozim vendim për themelimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale në komunën e Hanit të Elezit.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- e di që u ka skaduar më herët mandati dhe jemi me vonesë për me i themeluar këto këshilla. Si është paraparë çështja e këshillave të fshatrave, a do të jetë sikur ka qenë më herët apo do të shkojë në formë ndryshe.

Kryesuesi thekson:- më herët secili fshat e ka pasur administratorin e vetë, mirëpo tash në bazë të rregullores së re këshillat e fshatrave janë paraparë që të zgjidhen me zona që do të thotë se kanë me qenë katër këshilla të fshatrave. Disa fshatra do të bëhen me një fshat bashkë por përfaqësim do të ketë secili fshatë për shkak se në këshill do të përfshihen edhe anëtarët nga secila lagje apo fshatë. Kryetarët e këshillave të fshatrave do të kompensohen me pagesë për mbledhjet që do ti mbajnë dhe mëditja do të jetë sikur anëtarët e komiteteve obligative që e kanë. Sa do të jetë funksionale kjo çështje i mbetet kohës.

Nora Xhoni thekson:- është mirë që të potencohen edhe fshatrat se në cilën zonë do të bëjnë pjesë për shkak se tash janë vetëm katër këshilla të fshatrave.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PROPOZIM VENDIMI PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR PËRZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE NË KOMUNËN E HANIT TË ELEZIT QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

6. Plani i punës së këshillit komunal për siguri në bashkësi për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I PUNËS SË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

7. Plani i punës së komitetit për komunitete për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT PËR KOMUNITET PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

8. Plani i punës së komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara për vitin 2022.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sherif Berisha thekson:- duhet të ju mundësohet qasje personave me aftësi të kufizuara që me pasur qasje edhe në seancat e kuvendit të komunës por edhe në objekt të komunës, pra të jemi më transparent.

Sevdi Dernjani thekson:- në planin buxhetorë për vitin 2022 nuk është paraparë diçka e tillë, ndërsa në planin e punës së kryetarit të komunës për vitin 2022 është paraprirë një plan ideorë dhe e kemi dorëzuar nëpër disa organizata për me mundur me nxjerr ndonjë donacion.

Kryesuesi thekson:- me drejtoreshën e administratës e kemi diskutuar këtë çështje për me bërë liftin në mënyrë që edhe kjo kategori me pasur qasje në kuvend për shkak se kjo çështje është primare për me pasur qasje. A keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA PLANI I PUNËS SË KOMITETIT KONSULTATIV PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA PËR VITIN 2022 QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

9. Raporti financiar për vitin 2021 i N.P.L "Pastrimi" sh.a.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Sevime Bajrami thekson:- krahas materialit që është dërguar në material nuk janë të përfshirë vetëm obligimet por për mbledhje të kuvendit do ta përmirësojmë.

Refet Kalisi thekson:- si është gjendja me të hyrat në kompani.

Sevime Bajrami thekson:- të hyra ka pasur mirë por ka pasur edhe shpenzime.

Sherif Berisha thekson:- sa i përket kompanisë duhet t'i shikojmë çështjet më në detaje sepse në raport është shënuar , mirëpo në opinion flitet diçka tjetër.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA RAPORTI FINANCIARË PËR VITIN 2021 I NPL PASTRIMI SH A QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

10. Informatë mbi procesin e trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe legalizimin e tyre.

Kryesuesi thekson:- për këtë pikë të rendit të punës hapi diskutimin.

Nexhmedin Daci thekson:- në vitin 2021 ka pasur më shumë aplikues se sa në vitin 2020. Për vitin 2020 janë legalizuar vetëm dy objekte, ndërsa për vitin 2021 janë legalizuar 18 objekte. Janë realizuar të hyra në shumë prej 2465 € në emër të taksës për legalizim të shtëpive dhe në raport me vitin 2020 të hyra janë në shumë prej 900 €. Nëse keni ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të parashtroni.

Kryesuesi thekson:- a keni edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka e hedh në votim; rezultati i votimit ishte njëzëri.

U VOTUA INFORMATA MBI PROCESIN E TRAJTIMIT TË NDËËRTIMEVE PA LEJE DHE LEGALIZIMIN E TYRE QË TË PËRCILLET PËR KUVEND

11. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:46.

Procesmbajtësi
Ayri Bushi

